



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 416/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Fejzullah Rexhepi kryesues, Adnan Konushevcu dhe Faton Ademi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me ankesën e kandidates për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës Albena Reshitaj nga koalicioni LDK-AKR, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 01.07.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si e bazuar ankesa e Kandidates për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Albena Reshitaj nga koalicioni LDK-AKR.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për deputet nga koalicioni LDK-AKR në Vendvotimet: 0816c/02D, 2411A/02D, 2423A/02D, 0816c/01R, 2910B/01D, 3037A/01R, 2426A/01R, 2426A/02R, 2426A/04D.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të kutive të votimeve në Vendvotimet si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatit përfundimtar.

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 30.06.2017, nga kandidatja për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës Albena Reshitja nga radhët e koalicionit LDK-AKR, me të cilën pretendon se në vendvotimin 0816C/02D në qytetin e Klinës ekziston dyshimi se ka pasur mbishënim në procesverbalin e konstatimit të numrit të votave për kandidatin me nr. 42 të listës zgjedhore të koalicionit LDK-AKR respektivisht ne dobi të kandidates Mirjeta Kalludra (me nr. e listës zgjedhore 42)

Në vendvotimin 2411A/02D në Suharekë, në këtë vendvotim ka pasur parregullsi procedurale në përmbajtje të procesverbalit të votave ku anëtarët e komisionit në këtë vendvotim kanë nënshkruar vetëm faqen e parë të procesverbalit por nuk i kanë nënshkruar edhe 5 faqet e tjera të njëjtit procesverbal, ku këto faqe përfshijnë të dhënat për votat për kandidat për deputet.

Në vendvotimin 2426A/04D në Suharekë dy anëtarët e komisionit të vendvotimit Samedin Kadrijaj dhe Sokol Kadrijaj kanë kërcënuar palën ankuese Albena Reshitaj, pasi që e njëjta ka kërkuar sqarim lidhur me presionin që këta po ju bëjnë votuesve.

Në vendvotimin 2423A/02D në Suharekë në faqen e parë të procesverbalit për votat e kandidateve është mbi shënuar shenja “/” në rubrikat e kandidateve prej nr. 1 deri tek nr 43, ndërsa nga nr 44 i kandidateve në faqet vijuese të procesverbalit nuk ndodhe e njëjta gjë, konkretisht, kandidatëve prej nr. 1-43 (nr. 30 është nr. i Albena Reshitaj) në KQZ janë evidentuar si kandidat pa vota edhe pse në procesverbal shihet se ankuesja ka 4 vota të cilat përveç që nuk janë evidentuar në KQZ rubrikave i janë shënuar shenja “/”

Në vendvotimin 2411A/02D në Suharekë në procesverbalet e këtij vendvotimi gjenden nënshkrimet e anëtarëve të komisionit në këtë vendvotim, respektivisht këto nënshkrime mungojnë në faqen e parë të votave për kandidat përveç nënshkrimeve të dy anëtarëve, njëkosisht janë mbi shënuar nr. 15 në kandidatin për deputet nr 30 këtu ankueses Albena Reshitaj.

Në vendvotimin 0816C/01R në Klinë ka informacione se ka pasur parregullsi në evidentimin e nr. të votave për kandidat në KQZ në raport me votat në kuti të votimit, dhe se një nga anëtarët e komisionit për zgjedhje është anëtarë i familjes së Mirjeta Kalludrës.

Në vendvotimin 2910B/01D në Zveçan propozon që të hapet kutia e votimit dhe të bëhet krahasimi me të dhënat në procesverbal pasi që dyshon se ka pasur parregullsi.

Në vendvotimin 3037A/01R në Malishevë propozon që të hapet kutia e votimit dhe të bëhet krahasimi me të dhënat në procesverbal pasi që dyshon se ka pasur parregullsi

Në vendvotimin 2426A/01R në Suharekë, vëzhguesi Bujar Iballi deklaroi se nuk përputhen rezultatet e votave të shpallura nga KQZ me rezultatet që i njëjti i ka marrë në këtë vendvotim për kandidaten Albena Reshitaj.

Në vendvotimin 2426A/02R në Suharekë, vëzhguesi Bujar Iballi deklaroi se nuk përputhen rezultatet e votave të shpallura nga KQZ me rezultatet që i njëjti i ka marrë në këtë vendvotim për kandidaten Albena Reshitaj.

Parashtruesi i ankesës pretendon se gjatë këtij procesi zgjedhor është dëmtuar gjatë dhe pas numërimit të votave dhe i propozon PZAP-it që të behet hapja e kutive të votimit dhe rinumërimi i votave.

Parashtruesi i ankesës si prova materiale bashkangjitur Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularët e Përputhjes së të dhënave për vendvotimet e lartcekura.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

ankesa është e bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lendes, si dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, siç rezulton edhe nga provat e ofruara si dëshmi nga vete pala ankuese, andaj mbi këtë baze dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga koalicioni LDK-AKR në këto vendvotime si në vijim: 0816c/02D; 2411A/02D, 2423A/02D, 0816c/01R, 2910B/01D, 3037A/01R, 2426A/01R, 2426A/02R, 2426A/04D dhe rezultati i dalur nga ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare 2017.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 416/2017 më datën 01.07.2017.



Kryesuesi i Panelit

Fejzullah Rexhepi

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.